



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

**Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Pedagogjisë**

**Me datë: 29.04.2022**

1	Gresa Qosa	Ndikimi i vlerësimit formativ në nxitjen e bashkëpunimit mësimdhënës, nxënës dhe prindër	Kryetar/e	Vlora Sylaj	Miratohet
			Mentor/e	Arlinda Beka	
			Anetar/e	Blerim Saqipi	
2	Valjeta Zeqiri Rakovica	Ndikimi i të nxënësve të bazuar në situata në shkrimin e problemeve matematikore	Kryetar/e	Xhevat Krasniqi	Miratohet
			Mentor/e	Eda Vula	
			Anetar/e	Rozafa Ferizi-Shala	
3	Blinera Llugaliu	Identifikimi i çrregullimit të hiperaktivitetit tek fëmijët nga ana e edukatoreve në Institucionet Parashkollore	Kryetar/e	Naser Zabeli	Miratohet
			Mentor/e	Ardita Devolli	
			Anetar/e	Ganimete Kulinxha	
4	Qendresa Kelmendi	Opinionet e mësimdhënësve për vlerësimin e performancës së tyre në mësimdhënie nga drejtorët	Kryetar/e	Ethem Ceku	Miratohet
			Mentor/e	Demë Hoti	
			Anetar/e	Vjollca Ahmedi	
5	Kaqusha Aliu Beshiri	Roli i shkollës në arsimimin e të rinjve për jetë në familje	Kryetar/e	Majlinda Gjellaj	Miratohet
			Mentor/e	Demë Hoti	
			Anetar/e	Vlora Sylaj	
6	Blerina Krasniqi	Perceptimet e mësimdhënësve lidhur me sfidat e aplikimit të teknologjisë mësimore në shkollë	Kryetar/e	Kyvetë Shatri	Miratohet
			Mentor/e	Vlora Sylaj	
			Anetar/e	Vjollca Ahmedi	
7	Adelina Tahiri Surdulli	Perceptimet e nxënësve dhe mësimdhënësve për rolin e nxënësve në mësimdhënie tradicionale dhe bashkëkohore	Kryetar/e	Hatixhe Ismajli	Miratohet
			Mentor/e	Januz Dervodeli	
			Anetar/e	Rozafa Ferizi-Shala	

## **Gresa Qosa**

**Tema: Ndikimi i vlerësimit formativ në nxitjen e bashkëpunimit mesimdhënës, nxënës dhe prindër**

### **Komisioni:**

1. Arlinda Beka-mentore
2. Vlora Sylaj-kryetare
3. Blerim Saqipi-anëtar

### **Abstrakti**

Vlerësimi formativ është formë e vazhdueshme matjes së arritshmërisë të njohurive dhe shkathtësive të nxënësve. Mesimdhënësit përmes këtij lloji vlerësimi, kanë mundësinë që të përcjellin arritshmërinë e suksesit të nxënësve nga një nivel në tjetrin. Vëzhgimi dhe diskutimi në klasë janë teknika të cilat kanë bërë ndryshime dhe lehtësim në qasjen e mesimdhënësve drejt vlerësimit të nxënësve, gjithmonë duke pasur parasysh që vlerësimi formativ ka qëllim që të fitojë përmbledhjen e asaj se çfarë nxënësit dinë, përmes qasjes së llojeve të teknikave mesimore që mesimdhënësi i aplikon në orën mesimore.

Ky studim ka pasur për qëllim që të indentifikoj sa aplikohet kjo formë të vlerësimit nga mesimdhënësit. Gjithashtu të kuptohet rëndësia e ndikimit të vlerësimit formativ në krijimin e shprehive për nxenie efektive tek nxënësit, si dhe të analizojë ndikimin e kësaj forme të vlerësimit në rritjen dhe nxitjen e bashkëpunimit mesimdhënës, nxënës, prindër?

Ky studim është realizuar përmes metodës mikse. Për realizimin e hulumtimit është bërë anketimi i me prindër, si dhe intervista me mesimdhënës dhe nxënës.

***Fjalet kyçe:*** *Vlerësimi formativ, mesimdhënës, nxënës, prind, bashkëpunim.*

**Valjeta Zeqiri Rakovica**

**Tema: "Ndikimi i të nxënit të bazuar në situata në shtrimin e problemeve matematikore"**

**Komisioni:**

1. Prof. Asoc. Dr. Xhevat Krasniqi - kryetar
2. Prof. Ass. Dr. Rozafa Ferizi - anëtare
3. Prof. Dr. Eda Vula- mentore

**Abstrakti**

Shtrimi i problemeve matematikore është një komponentë shumë e rëndësishme për zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ në matematikë. Por, në ciklin fillor nuk është shumë i përhapur shtrimi i problemave matematikore si koncept. Edhe në tekstet shkollore nuk ka kërkesa të tilla të mjaftueshme që nxisin shtrimin e problemeve nga vetë nxënësit. Prandaj, përmes këtij studimi është shqyrtuar niveli i aftësisë së nxënësve të klasës së pestë në shkollën fillore për të shtruar probleme matematikore. Në mënyrë të veçantë është shqyrtuar ndikimi i të nxënit të bazuar në situata në përmirësimin e aftësive të nxënësve për të shtruar probleme.

Metodologjia e hulumtimit në veprim bashkëpunues me dizajnin quazi-eksperimental ka mundësuar të marrim përgjigje në pyetjen e hulumtimit:

- Çfarë ndikimi ka të nxënit të bazuar në situata në përmirësimin e aftësive të nxënësve në shtrimin e problemeve matematikore?

Hulumtimi është zhvilluar me 22 nxënës të klasës së pestë në ShFMU “Emin Duraku” në Prishtinë. Nxënësit i janë nënshtruar dy testeve, respektivisht para-testit dhe pas-testit për të parë nivelin e aftësive të nxënësve për shtrimin e problemeve matematikore me fjalë para dhe pas intervenimit, metodës që mbështet të nxënit e bazuar në situata dhe që zhvillohet në pesë faza: Analiza, Dizajni, Zhvillimi, Zbatimi dhe Vlerësimi (ADDIE)

Rezultatet e t-testit të mostrës së çiftëzuar tregojnë se ndryshimi i mesatareve të paratestit dhe pastestit është i rëndësishëm, prej nga mund të konkludohet se shfrytëzimi i të nxënit të bazuar në situata dhe metodës ADDIE ka pas një ndikim në rritjen e rezultateve të nxënësve dhe aftësimin e tyre për të shtruar probleme. Ndërsa analiza e mënyrës së shtrimit të problemeve nga nxënësit ka treguar se në rastet kur niveli i aftësisë së nxënësve për shtrimin e problemeve ishte i ultë, ndikohej pikërisht për shkak të vështirësive për të kuptuarit e strukturës që paraqitet në tekstin e problemeve me fjalë dhe në disa raste kur teksti nuk përputhet me të dhënat e kërkesës së detyrës. Në përgjithësi, studimi tregon se përdorimi i aktiviteteve që kërkojnë shtrimin e problemeve matematikore mundësojnë zhvillimin e të menduarit kritik, imagjinatën e kreativitetin e nxënësve por edhe të shprehurit, duke prekur kështu drejtëpërdrejtë dy nga kompetencat që parashihen të përmbushen nga nxënësit në kurrikulë, kompetencën e të shprehurit dhe atë të të menduarit.

**Fjalët kyçe:** *aftësi, problemet matematikore me fjalë, shtrimi i problemeve, të nxënit e bazuar në situata.*

---

**Blinera Llugaliu**

**Titulli: “Identifikimi i çrregullimit të hiperaktivitetit tek fëmijët nga ana e edukatoreve në Institucionet Parashkollore”**

**Komisioni:**

- 1.Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli - mentore
- 2.Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli - kryetar
- 3.Prof. Asoc. Dr. Ganimete Kulinxha - anëtare

### **ABSTRAKTI**

Ky punim është një hulumtim kuantitativ, qëllimi i të cilit ishte të hulumtojë për njohuritë e edukatoreve për identifikimin e fëmijëve me çrregullim të hiperaktivitetit dhe aftësinë për të punuar me fëmijë të tillë.

Mostër për këtë hulumtim kemi përfshirë gjithsej 130 edukatore nga Institucionet parashkollore në komunën e Prishtinës, të gjithat i takonin gjinisë femërore, ngase edhe profesioni është i përshtatshëm për këtë gjini.

Instrument për mbledhjen e të dhënave kemi përdorur pyetësoin, i cili është hartuar nga unë si studente, në bashkëpunim me mentoren e këtij punimi, të përshtatshëm për hulumtimin e problemit që kemi trajtuar në këtë punim të nivelit Master.

Pyetësoi i përdorur në këtë hulumtim përmban gjithsej 37 pyetje, prej tyre 5 janë demografike dhe 32 për hulumtimin e problemit që kam trajtuar. Nga të gjitha këto pyetje, 12 ishin të hapura dhe 25 ishin të mbyllura.

Analizimi i të dhënave dhe vërtetimi i hipotezave është bërë përmes programit SPSS (version 21). Për analizimin e të dhënave kam përdorur analizën e frekuencës, analizën deskriptive, Crosstabulation dhe analizën e besueshmërisë. Përmes analizës deskriptive të pyetjes së nëntëmbëdhjetë, kemi vërtetuar hipotezën e parë, e cila tregon se Edukatorët në institucionet parashkollore nuk kanë njohuri të mjaftueshme për identifikimin e simptomave që përcjellin fëmijët me çrregullimin e hiperaktivitetit (Mean = 1.42). Hipotezën e dytë, e kemi vërtetuar përmes analizës deskriptive të pyetjes së tetëmbëdhjetë, ku na tregon se njohuritë e marra përmes trajnimeve në lidhje me çrregullimin e hiperaktivitetit kanë qenë të nevojshme për to si edukatore (Mean = 1.17). Hipotezën e tretë, e kemi vërtetuar përmes pyetjes së shtatëmbëdhjetë dhe kuptojmë se njohuritë e marra gjatë studimeve në lidhje me çrregullimin e hiperaktivitetit nuk kanë qenë të mjaftueshme për shumicën e edukatoreve (Mean = 1.66).

**Fjalët kyçe:** *Çrregullimi i hiperaktivitetit, edukatorët, fëmijëria e hershme, identifikimi, simptomat.*

## **Qendresa Kelmendi**

**Tema: “Opinionet e mësimitdhënësve për vlerësimin e performancës së tyre në mësimitdhënie nga drejtorët”**

### **Komisioni:**

Prof. Ethem Ceku, kryetar

Prof. Demë Hoti, mentor

Prof. Vjollca Ahmedi, anëtare

### **ABSTRAKTI**

Studimi “Opinionet e mësimitdhënësve për vlerësimin e performancës së tyre në mësimitdhënie nga drejtorët” është një përpjekje për të ofruar dëshmi se çka mendojnë mësimitdhënësit rreth vlerësimit të performancës së tyre... çka përfshin vlerësimi në këtë rast?!

Konkretisht jemi përpjekur të zbardhim se cilat janë opinionet e mësimitdhënësve sa i përket vlerësimit të performancës së tyre në mësimitdhënie nga drejtori i shkollës?

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim është ajo me metoda të përziera, respektivisht anketimi si metodë sasiore (deduktive) dhe intervista si cilësore (induktive). Është studim përfaqësues dhe i takon qasjes ontologjike (ontos – qenie), meqenëse hulumton një situatë aktuale, respektivisht konstruktivizmit meqë idetë që janë marrë janë të ndërtuara dhe shqyrtohen e përpunohen nga personat e përfshirë aty, në rastin tonë, mësimitdhënësit.

Hulumtimi është realizuar në Prizren, në 4 shkolla fillore të këtij qyteti. Shkolla pjesëmarrëse në hulumtim ishin 2 nga qyteti, si dhe 2 nga fshatrat përreth (në territorin më të afërt me shkollat e qytetit, pjesëmarrëse në hulumtim).

Janë përfshirë gjithsejt 75 mësimitdhënës, nga 21 në shkollat urbane: 10 nga cikli i ulët dhe 10 nga cikli i lartë janë anketuar, kurse nga 1 mësimitdhënës është intervistuar, ku përzgjedhja e tyre ka qenë e rastësishme. Përderisa për shkak të numrit të vogël të nxënësve nëpër shkollat e fshatrave, edhe numri i mësimitdhënësve nuk ishte 20, që të anketohen, mirëpo në një të shkollë ishin 17 mësimitdhënës, kurse në tjetrën 14 (gjithsejt 31). Si rezultat, u anketuan të gjithë dhe u realizuan edhe intervistat sikurse janë paraparë. Poashtu pjesë e hulumtimit ishin edhe drejtorët e shkollave, përmes plotësimit të anketës së përpiluar enkas për ta.

Pas mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave është arritur në përfundim konkret se çka mendojnë mësimitdhënësit për procesin e vlerësimit të performancës së tyre, nga ana e drejtorit të shkollës ku ata punojnë.

**Fjalët çelës:** *drejtor, mësimitdhënës, opinion, performancë, vlerësim.*

**Kaqusha Aliu Beshiri**

**Tema: Roli i shkollës në arsimimin e të rinjve për jetë në familje**

**Komisioni:**

Prof. Majlinda Gjellaj, kryetare

Prof. Demë Hoti, mentor

Prof. Vlora Sylaj, anëtare

**Abstrakt**

Punimi trajton rolin e shkollë në përgatitjen e të rinjve për jetën në familje. Po ashtu analizon aspektet që mund të ketë rol më të rëndësishëm shkolla sa i përket edukimit të të rinjve për jetë në familje.

Popullacioni në të cilin do të kryhet hulumtimi përfshinë mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta nga qyteti i Prishtinës dhe fshatrat e saj. Me qëllim që hulumtimi të jetë gjithëpërfshirës, janë ftuar të përgjigjen në pyetësor mësimdhënës nga të gjitha fushat kurrikulare. Mostra e këtij hulumtimi është përbërë nga 100 mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta dhe atyre të mesme të larta nga Prishtina dhe fshatrat e saj. Për përpunimin e të dhënave është përdorur paketa statistikore për shkencat sociale (SPSS), rezultatet e nxjerra janë paraqitur në formë tabelare si dhe në formë të grafikoneve dhe të bazuara në tekstin Metodat e hulumtimit (Ross). Po ashtu është shqyrtuar edhe literatura që trajton problematikën në fjalë.

Hulumtimi zbuloi se sipas kurrikulës dhe planprogramve shkollore në Kosovë, shkolla ka një rol të rëndësishëm në përgatitjen e të rinjve që të arrijnë pjekuri/pavarësi dhe vetëvendosje, që të inkuadrohen në mënyrë konstruktive dhe efektive në jetën në familje, që të krijojnë raporte shoqërore dhe familjare, të jenë demokratikë dhe paqësorë. Analiza e teksteve mësimore vërteton hipotezën tonë se tekstet duhet të plotësohen dhe pasurohen me informata, sepse është vërejtur se kanë mangësi dhe nuk ofrojnë informata të mjaftueshme për të gjitha aspektet e jetës në familje.

Ndërkaq, të dhënat cilësore vërtetojnë se shkollat e hulumtuara shpeshherë u mundësojnë nxënësve të tyre të arrijnë rezultatet e sipërpërmendura, por jo gjithnjë, në nivelin e dëshiruar.

Bashkëjetesa me të tjerët, tejkalimi i sfidave me të cilat nxënësit do të ballafaqohen në jetë, ekonomia familjare, përgatitja e planeve të biznesit familjar, jetesa e shëndetshme, shëndeti seksual dhe planifikimi natyror familjar janë aspekte të jetës në familje në të cilat shkollat kanë arritur që në nivel mesatar të edukojnë nxënësit e tyre. Edhe pse gjithë këto aspekte janë paraparë edhe në programet lëndore për shkallët e përfshira në hulumtim, rezultati i arritur nuk është i kënaqshëm. Në nivel të kënaqshëm shkollat kanë arritur të edukojnë të rinjtë për këto aspekte të jetës në familje: ruajtjen e mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale të nxënësit dhe familjes dhe përgjegjësinë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe të tjerëve.

**Fjalët kyçe:** *familje, përgatitje për jetë, shkollë.*

**Blerina Krasniqi**

**Tema:** Perceptimet e mësimeve lidhur me sfidat e aplikimit të teknologjisë mësimore në shkollë

**Komisioni:**

Dr.sc.Vlora Sylaj/mentore

Dr.sc.Kyvetë Shatri/kryetare

Dr.sc.Vjollca Ahmeni/anetare

### **ABSTRAKTI**

Shekulli 21 do të mbahet mend për një zhvillim marramendës të teknologjisë. Ajo tani është bërë pjesë e rëndësishme e jona dhe që pa të është e vështirë të mendohet jeta. Për çdo pyetje që ne kemi, mjafton një kërkim i vogël në internet dhe gjen përgjigjen. Duke parë këtë gjë, shkollat kanë filluar t'i japin rëndësi të madhe aplikimit të saj nëpër secilën klasë të tyre.

Në ditët e sotme të zhvillimit të shoqërisë dhe rritjes me ritme të shpejta të teknologjisë, procesi i mësimdhënies është bërë mjaft kompleks dhe për ta thjeshtësuar këtë proces duhet përdorur metoda sa më efikase gjatë punës me nxënës.

Ky studim ka për qëllim që të identifikojë sfidat që kanë mësimeve tanë në aplikim të teknologjisë në shkollë, referuar perceptimeve të mësimeve.

Hulumtimi është i tipit sasior. Popullacion i këtij hulumtimi do të jenë mësimeve e Pejës. Mostrën e hulumtimit e përbëjnë 160 mësimeve. Në kuadër të këtij studimi do të përdoret pyetësori si instrument. Për mbledhjen e të dhënave do të përdoren si instrumente anketa me mësimeve.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të jenë produkte të ndërtuara nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura nga respondentët. Të gjeturat nga rishikimi i literaturës bashkëkohore dhe nga praktika edukativo-arsimore, do të jenë pjesë përbërëse e këtij hulumtimi.

**Fjalët kyçe:** *fëmijë, mësimeve, perceptim, sfida, shkollë, teknologji*

**Adelina Tahiri**

**Tema: Perceptimet e nxënësve dhe mësimitdhënësve për rolin e nxënësit në mësimitdhënien tradicionale dhe bashkëkohore**

**Komisioni:**

Prof. Hatixhe Ismajli, kryetare  
Prof. Januz Dervodeli, mentori  
Prof. Rozafa Ferizi-Shala, anëtare

## **ABSTRAKT**

Ndryshimet në mësimitdhënie u fokusuan në transformimin e teknikave tradicionale të procesit mësimit drejt disa teknikave të reja bashkëvepruese të cilat kishin për qëllim promovimin dhe zhvillimin e niveleve të larta të të menduarit të nxënësit sipas taksonomisë së Blumit. Kështu, arsimimi sot ka lëvizur në drejtimin në të cilin jo vetëm ka bërë që shkollat të ofrojnë një mundësi për të mësuar të rinjtë, por edhe duke u siguruar që ata mësojnë. Shkolla sot është një institucion që synon të përgatitë gjeneratat e reja për të kërkuar informacionin, për të operuar dhe analizuar në mënyrë kritike si dhe për të aftësuar nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin probleme në mënyrë kritike. Kjo do të mundësojë që nxënësit të jenë të përgatitur për të nxënë edhe atëherë kur do të përfundojnë shkollën, pra, kur do t'iu duhet të vazhdojnë të nxënë vetë në jetë.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është vlerësimi i pozicionimit të nxënësit në mësimitdhënien bashkëkohore dhe në mësimitdhënien tradicionale. Në këtë punim, ne do të përqendrohemi në rolin e gjerë të mësimitdhënies në përgjithësi e në veçanti të analizojmë rolin e aplikimit të mësimitdhënies tradicionale dhe mësimitdhënien bashkëkohore. Si qëllim dytësor i këtij hulumtimi është vlerësimi lidhur me perceptimet e nxënësve dhe mësimitdhënësve mbi metodën e mësimitdhënies që aplikohet pranë shkollës së tyre.

Metodologjia e këtij studimi është e tipit kuantitativ. Grumbullimi i të dhënave është i natyrës primare, sepse mbledhja e këtyre të dhënave është e bazuar në pyetesor. Lloji i mostrës është mostër probable / e qëllimshme, sepse hulumtimi fokusohet në marrjen e njohurive për një grup individësh me karakteristika specifike. Mostra e studimit është 100 nxënës dhe 10 mësimitdhënës dhe pjesëmarrëse janë 2 shkolla të komunës së Vushtrrisë.

Rezultatet: Nxënësit dhe mësimitdhënësit ngren lartë rolin dhe rëndësinë e mësimitdhënies bashkëkohore krahas asaj tradicionale.

**Fjalët kyçe:** *Mësimitdhënës, nxënës, mësimitdhënie tradicionale, bashkëkohore.*

---